



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE BËRTHAMORE

Nr. 18/2 prot

Tiranë, më datë 23/02/2021

URDHËR

Nr. 6, Datë 23.02.2021

“Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore”

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, “ *Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar (Kreu 2, neni 5 dhe neni 37, të ligjit në fjalë), ligjit nr.9131, datë 08.09.2003, “*Për rregullat e etikës në administratën publike*”, ligjit nr.90/2012 “ *Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit nr.9/2020 të KQZ-së “*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”,

KONSTATOJ:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr.254 prot, datë 18.02. 2021 “ *Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore*”, ka orientuar njësitë përgjegjëse, me qëllim zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, me qëllim vijueshmërinë normale të punës, të pandikuar nga fushata zgjedhore, gjatë veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:

1. Zana Gliozheni, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve, Kryetare
 2. Klaudia Mullari, Specialiste në Sektorin e Shërbimeve , Anëtare
 3. Jetmir Skuka, Specialist në Sektorin e Analizës, Anëtar
-
2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë **Znj. Klaudia Mullari (Specialiste)**.
 3. Grupi i monitorimit të hartojë deri në datën 25.02.21 rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek titullari i institucionit.
 4. Me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme të grupit të punës, të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës 10.03.2021, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
 5. Me zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Grupi i punës dhe Sektori i Shërbimeve.
 6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
Fatosh Klosi

